



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA GRAMSH
KRYETARI

Nr. 84 prot.

Gramsh, më 18/01/ 2021

Lënda: Kthim përgjigje kërkesës për informacion

Drejtuar: Znj, Kostandina Keruti, PARTNERS ALBANIA

Tiranë

E nderuar,

Në përgjigje të shkresës tuaj me datë 08.01.2021, regjistruar në Bashki me nr.84 prot., datë 11.01.2021, ju dërgojmë informacionin e kërkuar:

1. A keni ofruar mbështetje financiare për organizatat e shoqërisë civile gjatë vitit kalendarik 2020?
 - Po, kemi ofruar mbështetje financiare për organizatat e shoqërisë civile gjatë vitit 2020.
2. Nëse keni ofruar mbështetje, cila ka qënë forma e mbështetjes (grant, kontratë shërbimi, prokurim publik/tenderim etj.)
 - Forma e mbështetjes që kemi ofruar për shoqëritë civile ka qënë grant.
3. Sa organizata të shoqërisë civile kanë aplikuar për mbështetje financiare gjatë vitit 2020? Specifiko sipas formës nëse ka patur më shumë se një formë.
 - Gjatë vitit 2020 kemi pasur dy shoqëri civile, të cilat kanë aplikuar për mbështetje financiare.
4. Sa është numri i organizatave që kanë përfituar nga kjo mbështetje? Specifiko sipas formës nëse ka patur më shumë se një formë.
 - Gjatë vitit 2020 kanë përfituar nga kjo mbështetje dy shoqëri civile. Pra, të dyja shoqëritë civile që aplikuan për mbështetje financiare, përfituan mbështetjen financiare nga Bashkia.
5. Cila ka qënë shuma e përfitimit për organizatë dhe në total? Specifiko sipas formës nëse ka patur më shumë se një formë.
 - Gjatë vitit 2020 janë bërë dy kërkesa për mbështetje financiare të aktiviteteve të planifikuara të dy organizatave konkretisht: Shoqata e Invalidëve të Punës së Shqipërisë dhe Shoqata e të Verbërve dega Gramsh, të cilave i është akorduar fondi me 50.000 lekë të reja secilës dhe në total shkojnë 10.000 lekë të reja.
Në Bashkinë Gramsh nuk ka organizata të shoqërisë civile tepër aktive. Të vetmet kërkesa për mbështetje nga bashkia kanë qënë nga këto dy shoqatat, të cilat me fondin që i ka akorduar bashkia, kanë organizuar aktivitetet që kishin të planifikuar për vitin 2020.

6. A keni ofruar mbështetje jo-financiare për organizatat e shoqërisë civile gjatë vitit 2020? Cila është baza ligjore/rregullatore që rregullon këtë mbështetje?
-Jo, gjatë vitit 2020 nuk kemi ofruar mbështetje jo-financiare për shoqëritë civile. Nuk ka pasur as kërkesa për mbështetje jo-financiare gjatë këtij viti.
7. Nëse po, sa organizata kanë përfituar nga mbështetja jo-financiare e ofruar? Cili ka qënë lloji i mbështetjes jo-financiare të ofruar?
- Nuk është ofruar mbështetje jo-financiare, pasi nuk ka pasur kërkesa nga shoqëritë civile.

Punë të mbarë dhe gjithë të mirat!

Me konsideratë,



Konc/Dakt: E. Kaso
Afati: _____
Dosja: _____

